



Republika e Serbisë  
KOMUNA PRESHEVË  
KËSHILLI KOMUNAL  
III.037-11  
24.02.2025  
P R E S H E V Ë

Në mbështetje të nenit 20 Ligjit mbi informimin public dhe mediat („Gaz. Zyrtare RS”, nr..92/23), neni 44 parag.1 pika 5 të Ligjit mbi vetadministrimin local (“Gaz.zyrtare e Republikës së Serbisë”, nr.129/2007, 83/2014-ligji tj., 101/16-ligji tj., 47/18 dhe 111/21- ligji tj..) dhe Vendimi mbi buxhetin e komunës Preshevë për vitin 2025 („Gaz.zyrtare e Qytetit të Preshevës”, nr.12/24), Këshilli komunal I komunës Presehvë, nxjerr këtë

## V E N D I M

### **Për shpalljen e konkursit për bashkëfinansimin e projekteve për realizimin e interesit publik në lëmin e informimit publik në vitin 2025**

#### I

Më këtë Vendim shpallet Konkursi për bashkëfinansimin e projekteve për realizimin e interesit public në lëmin e informimit public në vitin 2025.

#### II

Me Vendimin mbi buxhetin e komunës Preshevë për vitin 2025 për bashkëfinansimin e projekteve për realizimin e interesit public në lëmin e informimit publik, janë ndarë mjete në shumë prej 2.000.000,00 din.

#### III

Mjetet nga neni 2 i këtij Vendimi do të ndahen në bazë të Konkursit public të zbatuar për bashkëfinansimin e projekteve për realizimin e interesit public në lëmin e informimit public në vitin 2025.

#### IV

Teksi I Konkursit public për bashkëfinansimin e projekteve për realizimin e interesit public në lëmin e informimit public në vitin 2025, është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

#### V

Vendimi hyn në fuqi me ditën e miratimit dhe do të shpallet në faqen e internetit të komunës Preshevë në portalin e sistemit të unifikuar informative të Ministrisë së informimit dhe telekomunikacionit të RS.

## ARSYETIM

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit mbi informimin public organi competent për punët e informimit public të njësisë së vetadministrimit local, në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet puna e organeve, nxjerr Vendimin për konkurset që shpallen gjatë vitit kalendarik. Organi i cili shpall konkurs është i obliguar që ta shpall më së voni deri më 1. Mars të vitit vijues për atë vit kalendarik.

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit të njejtë, me Konkurs përcaktohet: dedikimi i mjeteve që ndahen përmes konkursit dhe shuma e tyre, si dhe shuma minimale dhe maksimale që mund të lejohet për realizimin e projektit; e drejta për pjesëmarrje në Konkurs; kushtet për pjesëmarrje në Konkurs; kriteret për vlerësimin e projekteve; afatet në të cilat zbatohet konkursi dhe dokumentacioni që paraqitet nga paraqitësi i projektit. Me konkurs dërgohet edhe ftesa për propozimin e anëtarëve për punën e Komisionit për vlerësimin e projekteve të paraqitura në Konkursin e shpallur.

Me Vendimin e buxhetit të komunës Preshevë, për vitin 2025 janë ndarë mjete në vlerë prej 2.000.000,00 dinarë, për bashkëfinansim të projekteve për realizimin e interesit publik në fushën e informimit publik në teritorin e komunës Preshevë, të cilat ndahen në bazë të Konkursit publik për informim publik në fushën e informimit publik në teritorin e Komunës Preshevë.

Duke patur parasysh dispozitat ligjore të shënuara, Vendimi është miratuar si në dispozitiv.

## KËSHILLI KOMUNAL I KOMUNËS PRESHEVË

KRYETARJA E KOMUNËS,  
Ardita Sinani

